



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.618/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Kymete Kicaj dhe Afjete Sada Gllogjani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike-shtyllë elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17 Tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me numër protokoli Anr.618/2021 e datës 15.10.2021, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1,200.00 (një mijë e dyqind) euro, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike-shtyllë elektrike, me rastin e promovimit të subjektit politik dhe kandidatit për kryetar komune të këtij subjekti, duke ngjitur posterin në shtylla elektrike, me qëllim të përfitimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021.

II. Detyrohet Subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 15.10.2021, përmes postës, me të cilën pretendon se me datën 12.10.2021, rreth orës 16:00, aktivistët e subjektit të tyre nga Qendra në Lipjan, kanë vërejtur se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në fshatin Gadime e Epërme, në rrugën “Ekzodi 99”, për qëllime elektorale në rrugë publike përkatësisht në shtyllë elektrike kanë vendosur poster të subjektit politik LDK dhe kandidatit për kryetar z.Venhar Agushi.

Parashtruesi i ankesës pretendon se veprimet e lartcekura të subjektit politik LDK janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit dhe Kandidatët dhe janë të sanksionuara në bazë të nenit 33, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)-së dispozita të zbatueshme në kuptim të nenit 15 të Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi në formë të printuar nga rruga ku shihet posteri i vendosur në shtyllat elektrike.

Në përgjigjen në ankesë të datës 16.10.2021, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se ankesa e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duhet të hudhet poshtë si e pasafatshme ngase është ushtruar në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 5.5 të Rregullës Nr.02/2015 sepse nuk është ushtruar në afatin prej 24 orëve prej shkeljes së supozuar, por kanë kaluar më shumë se 72 orë dhe se përtej kësaj posteri i vendosur i theksuar si në ankesë nuk gjendet në atë pjesë më. Lidhur me këtë pretendim përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara të vendit ku është vendosur posteri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike Paneli, konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se kandidati për asamblistë Venhar Agushi dhe kandidati për kryetar të Komunës së Lipjanit, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik dhe vetvetes përmes posterit ka shfrytëzuar shtyllën elektrike në hapësirë publike duke vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Mbështetësit neni 33.1 e LZP-së, ku përcaktohet se: “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, shenja publike të trafikut...*”, duke bërë publik emrin e tij me numrin në listën zgjedhore të subjektit politik të LDK-së, gjë e cila është veprim i ndaluar sipas LPZ-së.

Paneli, gjatë vendosjes si në dispozitiv ka marrë parasysh po ashtu edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK-së, e cila me rastin e pranimit të ankesës për te dhënë përgjigje në ankesë, ka ndërmarrë veprime përmirësuese duke e larguar posterin lëndor nga shtylla elektrike, e cila ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, në të kundërtën gjoba do të ju shqiptohet 5,100.00 euro.

Andaj, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, Paneli ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në

procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes (shkelja është e përsëritur), pjesëmarrjen në proceset e më hershme zgjedhore të subjektit politik LDK, konsiston në faktin se kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, dhe se shkeljet e ligjeve dhe rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik LDK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 618/2021 më datën 18.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Komshyevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.